

## **BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA**

### **VENDIM TEKNIK Nr. 4-C**

#### **Për "Procedurën e Shlyerjes në Para dhe Procedurën e Vetëfaturimit"**

Duke pasur parasysh dispozitat e;

- I. Seksionit D.3.1 të kapitullit D, seksionet e kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes për transaksionet në Tregjet e ALPEX.

#### **ALPEX SHA Miratoi:**

1. Procedurën e Shlyerjes në Para dhe çështjet teknike,
2. Procedurën e Vetëfaturimit,
3. Vendim Teknik Nr.4-C i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë -ERE / Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATOR I ALPEX SHA**

**Sokol Dishnica**

## VENDIM TEKNIK Nr. 4-C

### NENI 1

#### 1. QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET

##### 1.1. Qëllimi dhe Fushëveprimi

Ky Vendim Teknik përcakton çështjet e mëposhtme në përputhje me Procedurën e Shlyerjes në Para :

- (a) pjesëmarrësit në Shlyerjen në Para,
- (b) parimet e përgjithshme të Procedurës së Shlyerjes në Para, dhe
- (c) Procedurën e Vetëfaturimit.

##### 1.2. Përkufizimet

- (a) Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë Vendim Teknik do të kenë të njëjtin kuptim si në Përkufizimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, përveç nëse është përcaktuar ndryshe.
- (b) Në çdo rast, dispozitat e këtij Vendimi Teknik interpretohen në përputhje me rregullat dhe parimet e parashikuara në paragrafin B.1.1.9 të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

### NENI 2

#### 2. PJESËMARRËSIT NË SHLYERJEN NË PARA

##### 2.1. Entitetet pjesëmarrëse

- (a) Përbushja e të gjitha llojeve të detyrimeve dhe pretendimeve monetare të Anëtarëve të Klerimit të cilat rrjedhin nga klerimi i transaksioneve në Tregjet e ALPEX-it, realizohet nga ALPEX-i nëpërmjet kontratës së tij me Bankën për Shlyerje, e cila administron shërbimet e nevojshme bankare në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe Procedurën e Shlyerjes në Para.
- (b) Në lidhje me shlyerjen në para të kryera nëpërmjet urdhër-komunikimit EMCS-Banka për Shlyerje, duke vepruar në emër të Anëtarëve të Klerimit në përputhje me këtë dhe kushtet specifike të Shtojcës I të saj, e cila është bashkangjitur këtu dhe formon një pjesë integrale të këtij Vendimi Teknik (këtej e tutje "Shtojca I").

## 2.2. Llogaritë Bankare për Shlyerje

- (a) ALPEX do të hap dhe mbajë dy Llogari Bankare për Shlyerje në emër të tij në mënyrë që të mund të kryejë pagesa dhe marr pagesa për Transaksionet e kryera në Tregjet e ALPEX.
- (b) ALPEX do të hap dhe mbajë dy Llogari Bankare për Shlyerje në emër të tij në mënyrë që të mund të marr pagesa për tarifatat fikse dhe tarifatat variabël nga Transaksionet e kryera në Tregjet e ALPEX.
- (c) ALPEX do të hap dhe mbajë një llogari në emër të tij për depozitimin e pjesës proporcionale të çdo Anëtari Klerimi në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve.
- (d) ALPEX do të hap dhe mbajë një Llogari Bankare për Shlyerje në emër të tij në mënyrë që të mund të kryejë pagesa dhe marr pagesa për Transaksionet e kryera në Bashkimin e Tregjeve.
- (e) Për qëllime të shlyerjes në para, çdo Anëtar i Klerimit duhet të mbajë një Llogari të Shlyerjes në Para në monedhën EUR dhe sipas rastit një Llogari të Shlyerjes në Para në monedhën ALL, në Bankën për Shlyerje me të cilën ALPEX-i është i lidhur në mënyrë kontraktuale në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike -Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes. Këto Llogari të Shlyerjes në Para do të përdoren për shlyerjet e detyrimeve të tij që rrjedhin nga Transaksionet në Tregjet e ALPEX. Banka për Shlyerje do të garantojë që këto Llogari të Shlyerjes në Para do të debitohet vetëm nëpërmjet urdhrat nga EMCS-ja ose nga instruksioni i ALPEX në rastet kur dështon komunikimi i sistemit EMCS- Bankë për Shlyerje.
- (f) Çdo Anëtar i Përgjithshëm Klerimi duhet të mbajë një Llogari bankare të Garancisë në Para në bankën e tij.
- (g) Çdo Anëtar Personal Klerimi duhet të mbajë një Llogari bankare të Garancisë në Para në Bankën për Shlyerje.
- (h) Llogaritë Bankare për Shlyerje në Para shfaqen në Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS), duke treguar gjendjen në para të debisë ose kredisë, të cilin Anëtari i Klerimit duhet ose të paguajë ose të ketë të drejta për të arkëtuar.
- (i) Çdo Anëtar i Klerimit duhet t'i duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim ALPEX-it numrin IBAN të Llogarive Bankare për Shlyerje të përmendura me sipër në paragrafin d). Në mënyrë të veçantë, në lidhje me shlyerjen në para e cila kryhet nëpërmjet ALPEX dhe Bankës për Shlyerje, përveç Anëtarit të Klerimit, Banka për Shlyerje gjithashtu ka detyrimin për t'i dhënë ALPEX-it detajet e një llogarie të cilën e ka hapur për një Anëtar Klerimi në përputhje me përcaktimet e Shtojcës

I. Pas verifikimit të të dy informacioneve dhe nëse nuk ka mospërputhje, ALPEX do të regjistrojë në EMCS këtë Llogari të Shlyerjes në Para e cila do të përdoret për përmbushjen e detyrimeve/pretendimeve të tij të shlyerjes, si dhe pagesën e tarifave në favor të ALPEX.

- (j) Në rast se bëhet e detyrueshme që Banka për Shlyerje nuk duhet të ketë këtë status që vjen si rezultat i revokimit të licencës së saj për operim ose të qënurit subjekt i procedurave të falimentimit, dhe si pasojë sjell ndërprerjen e shërbimeve përkatëse të ofruara prej saj në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, Anëtari i Klerimit, përkohësisht deri në hapjen e një llogarie të re ose llogarive të reja, nga një Bankë tjetër për Shlyerje, përdor procedurat alternative, sipas udhëzimeve përkatëse të ALPEX-it për përmbushjen e detyrimeve të Shlyerjes në Para . Në një rast të tillë, Anëtari i Klerimit duhet të marrë masa të menjëhershme për të siguruar që shërbimet respektive të ofrohen nga një Bankë tjetër për Shlyerje.

### **2.3. Njoftimi dhe verifikimi i të dhënave**

- (a) Anëtarët e Klerimit duhet të japin të gjitha të dhënat dhe informacionet e kërkuara nga ALPEX në lidhje me Llogaritë e tyre Bankare për Shlyerjen në Para të parashikuara këtu dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre. Ata gjithashtu duhet të njoftojnë ALPEX për çdo ndryshim të të dhënave në bazë mbi të cilat janë hapur Llogaritë përkatëse. Përveç Anëtarëve të Klerimit, Banka për Shlyerje gjithashtu ka detyrimin për t'i dhënë ALPEX-it çdo ndryshim në të dhënat e llogarive që ato mbajnë, për Anëtarët e Klerimit.
- (b) ALPEX ka të drejtën ligjore, në kuadrin e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të paraqitura me qëllim të hapjes dhe mbajtjes së Llogarive të mësipërme, për të shkëmbyer çdo të dhënë të nevojshme me autoritetet kompetente mbikëqyrëse, Bankën për Shlyerje, dhe me çdo palë tjetër të përfshirë në shlyerjen e transaksioneve, duke iu përmbajtur dispozitave për sekretin profesionale dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **NENI 3**

### **3. PARIMET E PËRGJITHSHME TË SHLYERJES NË PARA**

#### **3.1. Ciklet e Shlyerjes në Para**

- (a) Shlyerja në Para e transaksioneve kryhet në baza ditore, sipas cikleve siç parashikohet në procedurat e ALPEX-it. Anëtarët e Klerimit informohen në nëpërmjet Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS) ose me çdo mjet tjetër të përshtatshëm njoftimi dhe komunikimi.

- (b) Shlyerja në Para e transaksioneve, të cilat nuk mund të shlyhen brenda një cikli të caktuar në një Ditën e Shlyerjes, për shkak të mosplotësimit të kushteve të Shlyerjes që i rregullojnë ato, transferohen automatikisht në ciklin që vjen menjëherë më pas në përputhje me proceset teknike të Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS).

### **3.2. Kushtet e Shlyerjes në Para**

- (a) Shlyerja në Para e transaksioneve kryhet mbi bazë shumëpalëshe midis ALPEX dhe Anëtarëve të saj të Klerimit.
- (b) Shlyerja në Para kryhet për çdo Anëtar Klerimi, Llogari Klerimi dhe Llogari për Shlyerje në Para. Pretendimet dhe detyrimet korresponduese, të cilat shlyen në të njëjtën Ditë Shlyerjeje janë subjekt i netimit. Në mënyrë të veçantë, llojet e ndryshme të të drejtave dhe tarifave nuk janë subjekt i netimit kundrejt detyrimeve, pretendimeve dhe tarifave të tjera ALPEX.

## **NENI 4**

### **4. PROCEDURA E VETËFATURIMIT**

Anëtarët e Bursës dakortësojnë që ALPEX-i do të lëshojë vetëfaturat në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes në tërësinë e tyre, dhe veçanërisht bazuar ne Seksionin G.4.3.

Për tu kryer lëshimi i Vetëfaturimit nga ALPEX, Anëtarët e Bursës dhe ALPEX në referim të Ligjit “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” neni 100, pika 1) duhet të kenë një marrëveshje ndërmjet palëve me kusht që të ekzistojë një procedurë për pranimin kësaj fature Vetëfaturimi /në Kosovë sipas ligjit nuk parashihet por dhe nuk përjashtohet ndonjë marrëveshje për vetëfaturim, në këto raste marrëveshja do të bazohet ne parashikimet e Nenit 6 pika 4, 4.1 të Udhëzimit Administrativ MFPT Nr. 01/2023, të Republikës së Kosovës.

ALPEX u dorëzon Anëtarëve të Bursës faturat e lëshuara nëpërmjet procedurës së Vetëfaturimit, sipas legjislacionit fiskal në fuqi i cili do të përmbajë informacionin e siç është përcaktuar në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

Anëtarët e Bursës mbeten të detyruar të përmbushin detyrimet e tyre ligjore të dala nga lëshimi i faturave dhe detyrimeve të tjera ligjore (kontabël, taksat, raportimi), si dhe çdo detyrim tjetër përkatës. ALPEX-i nuk është përgjegjës për mos përmbushjen e detyrimeve ligjore të mësipërme në emër të çdo Anëtari Burse. Anëtarët e Bursës ndërmarrin detyrimin për t'i dhënë ALPEX-it informacion të vlefshëm dhe në kohë (p.sh. emri i plotë, numrin e NUIS / NUI) dhe çdo informacion dhe të dhënë tjetër, me qëllim që ALPEX të përmbushë procedurën e Vetëfaturimit.

## NENI 5

### 5. HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi në 07/09/2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen e internetit [www.alpex.al](http://www.alpex.al)

## SHTOJCA I

**"Shembujt e Deklarimeve nga Banka për Shlyerje dhe Anëtarët e Klerimit në lidhje me urdhër-komunikimin e EMCS-Banka për Shlyerje"**

### Shembulli 1

Për:

**Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA**

Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,

Shkalla 3, Kati 1, Zyra 1, Tiranë, Shqipëri.

Tiranë\_\_\_\_\_

## OSE PER TREGUN E KOSOVËS

Për:

**Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA-Dega në Kosovë**

Rruga Ali Pashë Tepelena,

Kati II, Nr.1, Prishtinë, Kosovë.

Prishtinë\_\_\_\_\_

**"Deklaratat nga Banka për Shlyerje dhe Anëtarët e Klerimit"**

**DEKLARATA & KUSHTET E VEÇANTA NË DHËNIEN E SHËRBIMEVE TË BANKËS PËR SHLYERJE NË SHËRBIMET E SISTEMIT TË SHLYERJES**

Emërtimi Ligjor i Subjektit ..... me adresë ..... në ....., me Nr. NUIS/NUL....., i përfaqësuar ligjërisht nga Z. ...., e cila do të veprojë si Banka për Shlyerje siç përcaktohet më konkretisht (në vijim "Banka për Shlyerje"),

**Duke marrë parasysh:**

- 1) Faktin që ALPEX, duke vepruar si Kundërpalë Qendrore, kryen shlyerjen në para të Transaksioneve në Tregjet e ALPEX në kuadër të dhënies së shërbimeve përkatëse për Anëtarët e Klerimit nëpërmjet Sistemi të Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS).
- 2) Faktin që shlyerja në para e këtyre Transaksioneve realizohet nëpërmjet ALPEX dhe Bankës për Shlyerje, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, si dhe faktin që Sistemi përkatës i Klerimit të ALPEX- it cili është i lidhur me Bankën për Shlyerje, (në vijim " Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes").
- 3) Faktin që ALPEX, duke vepruar si Kundërpalë Qendrore, kryen shlyerjen në para të Transaksioneve në Tregjet e ALPEX dhe për këtë aplikon tarifën variabël të tregtimit dhe klerimit për transaksionet në monedhën EUR për Anëtarët e Bursës në kuadër të dhënies së shërbimeve përkatëse për Anëtarët e Klerimit nëpërmjet Sistemit të Klerimit (EMCS).
- 4) Faktin që Anëtari i Klerimit, duke vepruar si Kundërpalë, kryen shlyerjen në para të penaliteteve në kuadër të dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes sipas udhëzimeve përkatëse të ALPEX
- 5) Faktin që Anëtari i Klerimit, duke vepruar si Kundërpalë, kryen shlyerjen në para të tarifave fikse (nëse nuk mund të kryen automatikisht) në kuadër dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes sipas udhëzimeve përkatëse të ALPEX.
- 6) Kushtet e funksionimit të Bankës për Shlyerje në bazë të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, e cila ofron shërbime të Shlyerjes në Para, nëpërmjet ALPEX dhe Bankës për Shlyerje, nëpërmjet pjesëmarrjes në Sistemin e Shlyerjes.

**Me këtë deklaron:**

Se do të veprojë si Bankë për Shlyerje në referencë të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes në Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes dhe do të sigurojë të gjitha shërbimet e duhura për ALPEX dhe Anëtarët e tij të Klerimit në përputhje me Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes si dhe me përcaktimet përkatëse të përcaktuara në Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe procedurat . Për këtë qëllim, ai deklaron solemnisht se do të

nënshkruajë të gjitha dokumentet e nevojshme që i janë udhëzuar nga ALPEX dhe do të kryejë të gjitha veprimet e duhura siç mund të tregohet nga Procedurat e lartpërmendura, duke pranuar pa rezerva çdo dhe të gjitha detyrimet që burojnë nga statuti i sipërpërmendur si dhe detyrimet e tij më specifike që rrjedhin nga Kushtet e Veçanta sipas dispozitave të Shërbimeve Bankare për Shlyerje për Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes në kuadër të ALPEX dhe Bankës për Shlyerje, pasi këto terma janë specifikuar nga ALPEX dhe janë si më poshtë:

**Kushte të Veçanta mbi sigurimin e Shërbimeve Bankare të Shlyerjes në Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes në kuadër të ALPEX dhe Bankës për Shlyerje (Kushte të Veçanta)**

1. Për të lehtësuar shlyerjen në para të transaksioneve në Tregjet ALPEX që janë të vendosura nëpërmjet Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes në kuadër të ALPEX dhe Bankës për Shlyerje, termat e veçantë të mëposhtme do të aplikohen në lidhje me sigurimin e shërbimeve nga Banka për Shlyerje kundrejt ALPEX dhe Anëtarëve të Klerimit në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe Rregullat e ALPEX dhe Procedurat.
2. Banka për Shlyerje është e detyruar të:
  - 2.1 Dorëzojë në ALPEX të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme, siç mund të jenë numrat e llogarive, gjendja e llogarive, dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, vetëm në lidhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, duke ja mundësuar ALPEX-it si një entitet i Shërbimit të Sistemit të Shlyerjes.
  - 2.2 Njoftojë ALPEX-in për çdo ndryshim të të dhënave ose informacionit të paraqitur sipas 2.1 më lart.
  - 2.3 Pajtohet me kushtet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, sipas të cilës shlyerja në para kryhet në Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes, ose me kushtet e çdo procedure tjetër shlyerje që mund të udhëzohet nga ALPEX.
  - 2.4 Hapë Llogari për Shlyerje në Para në emër të ALPEX në mënyrë që të mund të kryhen pagesat e detyrimeve dhe/ose arkëtimet e të drejtave për Transaksionet në Tregjet e ALPEX.
  - 2.5 Hapë Llogari për Shlyerje në Para në emër të ALPEX në mënyrë që të mund të kryhet arkëtimi i tarifave fikse dhe variabël nga Transaksionet në Tregjet e ALPEX.
  - 2.6 Hapë një llogari në emër të ALPEX për depozitimin e pjesës proporcionale të çdo Anëtari Klerimi në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve.
  - 2.7 Hapë me një kërkesë të thjeshtë të paraqitur nga një Anëtar Klerimi dhe ALPEX, një llogari për Shlyerje në Para ndërmjet ALPEX dhe Anëtarit të Klerimit dhe e mban këtë llogari në emrin e ALPEX dhe hap një llogari për Shlyerje në Para në



emër të çdo Anëtari Klerimi në mënyrë që të jetë në gjendje të kryejë pagesa ose të arkëtojë nëpërmjet bashkëveprimit midis ALPEX dhe Anëtarëve të Klerimit.

- 2.8 Hapë Llogari bankare të Garancisë në Para ndërmjet ALPEX dhe Anëtarit Personal të Klerimit dhe e mban këtë llogari në emër të ALPEX për t'u përdorur, sipas udhëzimeve të ALPEX dhe gjithmonë në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe Vendimin Teknik.
- 2.9 Marrë masa për të siguruar komunikimin midis secilës nga llogaritë e mësipërme, në mënyrë që të mundësojë – në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimin Teknik të ALPEX – veprimtarinë e nevojshme të rrjedhjes së parasë së pari nga llogaritë e Shlyerjes në Para në llogarinë për Shlyerje në Para të ALPEX-it për pagesat dhe së dyti nga këto të fundit në llogarinë individuale të Shlyerjes në Para të Anëtarit të Klerimit. Me qëllim të sigurimit të këtij komunikimi, Banka për Shlyerje do të ketë akses në llogarinë individuale të Shlyerjes në Para të Anëtarit të Klerimit ose, në mënyrë alternative, Anëtari i Klerimit duhet të marrë masa për të siguruar që paratë e nevojshme të transferohen në çdo rast në Bankën për Shlyerje, nëpërmjet llogarive përkatëse dhe në përputhje me procedurat specifike të dakortësuar çdo herë nga Banka për Shlyerje dhe Anëtari i Klerimit.
- 2.10 Kryejë brenda afatit të përcaktuar, debitimin dhe kreditimin e nevojshëm midis Llogarive të Shlyerjes në Para të përmendura më sipër, në 2.9.
- 2.11 Njoftojë menjëherë Anëtarët e Klerimit në rast të ndonjë dështimi, mosfunksionimi, problemeve teknike në përgjithësi apo emergjenca të tjera që ndërpresin funksionimin e Llogarive të tyre individuale përkatëse të Shlyerjes në Para dhe në përgjithësi ndikojnë në funksionimin e qetë të Shlyerjes në Para.
- 2.12 Njoftojë menjëherë ALPEX në rast të ndonjë dështimi, mosfunksionimi, problemeve teknike në përgjithësi apo emergjencave të tjera që ndërpresin funksionimin e Llogarive individuale të Shlyerjes në Para të një Anëtari Klerimi ose të të gjithë Anëtarëve të Klerimit të cilëve u siguron shërbime.
- 2.13 Ketë:
  - a) personelin e specializuar për kryerjen e të gjitha operacioneve në lidhje me kryerjen dhe mbikëqyrjen e Shlyerjes në Para ,
  - b) personelin rezervë, për mbulimin e përshtatshëm të nevojave të saj të Shlyerjes në Para , veçanërisht në rastet e grevave nga punonjësit e saj,
  - c) sistemet alternative për hyrjen dhe ruajtjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me funksionimin e saj si një Bankë për Shlyerje, si dhe një qendër fatkeqësie për trajtimin dhe mbarëvajtjen e emergjencave, veçanërisht në rast të mosfunksionimit të mekanizmave që e lidhin me Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes dhe, në përgjithësi, për pjesëmarrësit në Shlyerjen në Para , ose çdo

emergjencë tjetër, të cilën qendra do ta aktivizojë në mënyrë që të mbrojë funksionimin e duhur të procesit të Shlyerjes në Para .

- 2.14 Ruajtë konfidencialitetin e nevojshëm në lidhje me të gjitha të dhënat dhe informacionet që përmbahen në sistemin e saj elektronik, në kuadrin e detyrimeve të saj si Bankë për Shlyerje, si dhe çdo të dhënë dhe informacion tjetër që mund të vijë në dijeninë e saj gjatë kryerjes së veprimtarive që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me detyrimet e saj të lartpërmendura, për të gjithë kohëzgjatjen e funksionimit të saj si një Bankë për Shlyerje si dhe pas përfundimit të saj, marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar zbulimin e tyre, në tërësi ose pjesërisht, ndaj palëve të treta, organizatave ose shërbimeve të paautorizuara në përgjithësi, me përjashtim të atyre rasteve në të cilat detyrimi për të mbajtur konfidencialitetin ose fshehtësinë nuk është i zbatueshëm në bazë të legjislacionit dhe, me anë të treguesve, në kuadrin e dhënies së informacionit autoriteteve kompetente mbikëqyrëse ose gjyqësore. Për këtë qëllim, ajo do të sigurojë që dispozitat e mësipërme të respektohen gjithashtu edhe nga personat e punësuar prej saj për funksionimin e saj si një Bankë për Shlyerje. Është e dukshme se Banka për Shlyerje mund të japë të dhënat dhe informacionin e mësipërme lidhur me Anëtarët e Klerimit dhe ALPEX në realizimin e detyrave të saj të ligjshme.
3. Banka për Shlyerje duhet të hapë dhe të mbajë llogaritë e mësipërme në përputhje me këto Kushte të Veçanta. Banka për Shlyerje duhet të jetë përgjegjëse, për kalimin brenda afatit dhe me korrektësi të detyrimeve/pretendimeve në para kundrejt Shlyerjeve përkatës në Para. Për më tepër, ajo duhet të jetë përgjegjëse për plotësinë, korrektësinë dhe saktësinë e të dhënave, lëvizjeve dhe gjendjeve të llogarive të mësipërme që ajo i ofron Anëtarëve të Klerimit në përputhje me këto Kushte të Veçanta.
  4. Bankës për Shlyerje nuk i lejohet të mbyllë ndonjë llogari të mbajtur për një Anëtar Klerimi, përveç nëse fillimisht është hapur një llogari e re për Anëtarin e Klerimit nga një Bankë tjetër për Shlyerje ose nga vetë Anëtarin e Klerimit, në rastin kur vepron si një Bankë për Shlyerje. Asnjë llogari nuk mund të mbyllet menjëherë përveç rastit kur ka humbur kapacitetin e Anëtarit të Klerimit, sipas njoftimit përkatës të Bankës për Shlyerje nga ALPEX.
  5. Bankës për Shlyerje nuk i lejohet t'u transferojë palëve të treta të drejtat ose detyrimet në lidhje me Anëtarin e Klerimit që rrjedh nga kapaciteti i saj si Bankë për Shlyerje në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimin Teknik të ALPEX dhe këto Kushte të Veçanta. Ky ndalim nuk zbatohet në rast të përthithjes së tij, për ndonjë arsye apo shkak, si pasojë e transformimit të korporatës (veçanërisht, për shembull, në rastet e bashkimit të saj me, ose të blerjes nga një bankë tjetër).
  6. Banka për Shlyerje do të lejohet të ndërpresë sigurimin e shërbimeve përkatëse në Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes me kusht që kjo t'i komunikohet me shkrim ALPEX-it,

dhe një njoftim i tillë përbën përfundimin e të gjitha marrëveshjeve të lidhura me Bankën për Shlyerje, si edhe të kapacitetit të saj si të tillë, me ALPEX. Ndërprerja (dhe përfundimi) i lartpërmendur do të hyjë në fuqi pas 6 (gjashtë) muajve nga njoftimi i mësipërm pa paragjykuar parashikimet e mëposhtme:

- 6.1 Ndërprerja do të jetë i efektshëm me kusht që Banka për Shlyerje ka rregulluar, brenda afatit kohor të përcaktuar më sipër, të gjitha çështjet në pritje ose detyrimet kundrejt ALPEX dhe që Anëtarët e Klerimit të cilëve u ofron shërbime kanë siguruar llogaritë e nevojshme në Banka e tjera për Shlyerje, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimit Teknik të ALPEX dhe të procedurave të ALPEX. ALPEX mund të caktojë një afat kohor më të gjatë, nëse kjo është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme të Bankës për Shlyerje në fjalë dhe/ose për mbrojtjen e sistemeve të klerimit dhe shlyerjes të lidhura me ALPEX. Në rast të një afati më të gjatë, data e ndërprerjes dhe efektet e saj do të zgjaten përkatësisht.
- 6.2 Pas plotësimit të kushteve nën 6.1, ALPEX do të pranojë ndërprerjen e lartpërmendur të shërbimeve dhe do të informojë Bankën për Shlyerje në përputhje me këtë. Nëse nuk pranon ndërprerjen, duhet të japë një përgjigje të arsyetuar.

### **Për bankën për Shlyerje**

*(Ju lutem vendosni emrin e plotë të entitetit ligjor*

*dhe shtoni emrin & nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor)*

## Shembulli 2

Në

### **Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA**

Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,  
Shkalla 3, Kati 1, Zyra 1, Tiranë, Shqipëri.

OSE

### **Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA-Dega në Kosovë**

Rruga Ali Pashë Tepelena,  
Kati II, Nr.1, Prishtinë, Kosovë.

## **DEKLARATA E PËRBASHKËT E BANKËS PËR SHLYERJE DHE ANËTARIT TË KLERIMIT NË LIDHJE ME SISTEMIN E SHLYERJES NË KUADRIN E RREGULLAT E TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE - KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE PROCEDURAT**

Tiranë,/ Prishtinë, .....

- 1) Emërtimi Ligjor i Subjektit....., me adresë ..... në ....., me Nr. NUIS/NUI....., i përfaqësuar ligjërisht nga Z. ...., e cila vepron si Banka për Shlyerje për Sistemin e Shlyerjes së ALPEX (në vazhdim "Banka për Shlyerje") dhe "Deklarata & Kushtet e Veçanta në dhënien e Shërbimeve të Bankës për Shlyerje për Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes në kuadrin e ALPEX dhe Bankës për Shlyerje".
- 2) Emërtimi Ligjor i Subjektit....., me adresë ..... në ....., me Nr. NUIS/NUI....., e përfaqësuar ligjërisht nga Z. ...., i cili është një Anëtar Klerimi me kodin nr. .... në përputhje me kushtet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për Transaksionet në Tregjet ALPEX sipas miratimit nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë në Republikën e

Shqipërisë sipas vendimit nr.347 datë 27/12/2022 / Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike të Republikës së Kosovës me vendimin Nr. V\_1638\_2022, datë 27/12/2022.

**3) Duke marrë parasysh:**

- 1) Faktin që ALPEX, duke vepruar si Kundërpalë Qendrore, kryen shlyerjen në para të transaksioneve në Tregjet ALPEX në kuadër të ofrimit të shërbimeve përkatëse për Anëtarët e Klerimit që marrin pjesë në Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS) të ALPEX.
- 2) Faktin që shlyerja në para e këtyre tregtimeve realizohet nëpërmjet ALPEX dhe Bankës për Shlyerje, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës të Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimit Teknik të ALPEX, si dhe faktin se sistemi përkatës i shlyerjes, është i lidhur me Bankën për Shlyerje (në vijim "Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes").
- 3) Kushtet e funksionimit të Banka për Shlyerje në zbatim të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës të Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimit Teknik të ALPEX, i cili ofron shërbime të Shlyerjes në Para, nëpërmjet ALPEX dhe Bankës për Shlyerje, nëpërmjet pjesëmarrjes në Sistemin e Shlyerjes (Banka për Shlyerje).

**Në këtë deklarojnë si vijon:**

Banka për Shlyerje dhe Anëtari i Klerimit kanë rënë dakord që i pari duhet t'i sigurojë këtij të fundit shërbimet në lidhje me Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes me qëllim që të lehtësojë Anëtarin e Klerimit në shlyerjen e tij në para të transaksioneve, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimit Teknik të ALPEX dhe "Kushtet e Veçanta mbi sigurimin e Shërbimeve Bankare të Shlyerjes në Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes" të cilën Banka për Shlyerje ka aderuar në bazë të deklaratës së saj "DEKLARATË & KUSHTET E VEÇANTA MBI DHËNIEN E SHËRBIMEVE TË BANKËS PËR SHLYERJE NË SISTEMIN E SHLYERJES NË KUADËR TË ALPEX DHE BANKËS PËR SHLYERJE", në datë....., për ALPEX.

Si pjesë e kësaj marrëveshjeje, Banka për Shlyerje do të hapë dhe mbajë për Anëtarin e Klerimit të gjitha llogaritë e nevojshme, siç është udhëzuar, si Bankë për Shlyerje, në përputhje me kushtet e këtushme. Banka për Shlyerje, duke qenë në dijeni të detyrimeve të saj respektive, duhet të marrë të gjitha hapat e nevojshme për t'i siguruar Anëtarit të Klerimit shërbimet bankare të shlyerjes dhe do të informojë ALPEX-in në përputhje me rrethanat, në zbatim të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes ose vendimin teknik të ALPEX dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe procedurat.

Anëtari i Klerimit ka pranuar ofrimin e shërbimeve bankare të shlyerjes nga Banka për Shlyerje, në përputhje me kushtet e mësipërme dhe do të përmbushë detyrimet e saj të shlyerjes në para nëpërmjet llogarive të mësipërme.

Detajet e llogarive tashmë të hapura për Anëtarin e Klerimit janë si më poshtë:

Emri i Bankës për Shlyerje

BIC i bankës për Shlyerje

Emri i Anëtarit të Klerimit

Kodi i ALPEX-it

Llogaria IBAN

Titulli i llogarisë ALPEX – Emri i Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit

Për më tepër, gjithashtu është rënë dakord dhe deklaruar shprehimisht se Banka për Shlyerje dhe Anëtari i Klerimit:

- 1) Ndërmarrin angazhimin për të njoftuar ALPEX për çdo ndryshim në të dhënat e Llogarisë së mbajtur nga Banka për Shlyerje për Anëtarin e Klerimit në përputhje me sa më sipër, siç mund të jetë rasti.
- 2) Duhet të veprojnë në përputhje me procedurën për shlyerje siç udhëzohet çdo herë nga ALPEX në bazë të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës të Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimit Teknik të ALPEX.
- 3) Duhet të adaptojnë procedurat e përshtatshme për lidhjen e llogarive individuale të shlyerjes së Anëtarit të Klerimit me llogarite e mbajtura për të nga Banka për Shlyerje në përputhje me sa më sipër dhe do të kryejë debitimet dhe kreditimet e nevojshme nëpërmjet llogarive të lartpërmendura me qëllim që të sigurojë përmbushjen në kohë dhe të duhur të detyrimeve të tyre respektive ndaj ALPEX-it në interes të funksionimit të butë të Shlyerjes në Para.
- 4) Duhet të bashkëpunojnë, në rast të ndonjë dështimi, mosfunksionimi, problemesh teknike në përgjithësi ose emergjencave të tjera që ndërpresin funksionimin e përcaktuar nën 3) më sipër dhe do të njoftojnë ALPEX-it në përputhje me rrethanat pa vonesë në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre ndaj këtij të fundit, në përputhje me Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, në lidhje me shlyerjen në para .
- 5) Duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që, në qoftë se një llogari e mbajtur nga Banka për Shlyerje për Anëtarin e Klerimit është mbyllur, ose nëse Banka për Shlyerje ndërpret ofrimin e shërbimeve të saj, siç është përcaktuar në "Kushtet e Veçanta mbi Sigurimin e Shërbimeve Bankare të Shlyerjes në Shërbimet e Sistemit të Shlyerjes ", të nënshkruar nga Banka për Shlyerje, të sigurohet një llogari e re korresponduese të jetë hapur për Anëtarin e Klerimit në Bankën për Shlyerje ose nga vetë Anëtari i Klerimit, në rastin kur po vepron si Bankë për Shlyerje dhe se ALPEX do të ketë marrë të dhënat që lidhen me llogarinë e re përpara mbylljes së llogarisë në fjalë. Banka për Shlyerje pranon gjithashtu se nuk do të mbyllë menjëherë një llogari përveç rastit kur kjo është e nevojshme për shkak të humbjes së kapacitetit të Anëtarit të Klerimit dhe me kusht që të jetë njoftuar

më parë nga ALPEX. Në çdo rast, në mënyrë që të mbyllë një llogari, Banka për Shlyerje deklaron se do të plotësojë formularin e mbylljes dhe duke i përcjellë gjithashtu një kopje ALPEX, në përputhje me Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.

Për më tepër Anëtari i Klerimit deklaron se është vënë në dijeni të së drejtës së tij në bazë të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, në rast të fshirjes së detyrueshme të Bankës për Shlyerje, me anë të treguesve për shkak të heqjes së licencës së saj të operimit ose procedurës së falimentimit dhe për këtë arsye ndërprerjes së shërbimeve përkatëse të saj në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes ose Vendimin Teknik të ALPEX, përkohësisht dhe deri në hapjen e një llogarie të re ose llogarive për të nga një Bankë tjetër për Shlyerje, të përdorë shërbimet përkatëse të ALPEX-it me qëllim që të përmbushë detyrimet e saj të shlyerjes në para. Në lidhje me këtë, Anëtari i Klerimit deklaron se në një rast të tillë do të marrë menjëherë masa për të siguruar shërbimet përkatëse tek një Bankë tjetër për Shlyerje.

Banka për Shlyerje dhe Anëtari i Klerimit ndërmarrin angazhimin për të vepruar, në përgjithësi, në përputhje me udhëzimet e ALPEX-it në mënyrë që të sigurojnë përmbushjen e duhur të detyrimeve të tyre përkatëse të shlyerjes në para ndaj ALPEX.

#### **Për bankën për Shlyerje**

*(Ju lutem vendosni emrin e plotë të entitetit*

*ligjor dhe emrin & nënshkrimin*

*e përfaqësuesit ligjor)*

#### **Për Anëtarin e Klerimit**

*(Ju lutem vendosni emrin e plotë të entitetit*

*ligjor dhe emrin &*

*e përfaqësuesit ligjor)*